

VENDIM
Nr. 10, datë 5.2.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR KREDINË
KONSUMATORE DHE KREDINË HIPOTEKARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe nenit 124 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 1.7.2015, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 5, pika 2, shkronja “a/1”, pjesa e fjalisë *“si mesatare e normës efektive të interesit të aplikuar nga subjektet sipas llojit të kredisë konsumatore, duke konsideruar/shtuar edhe një të tretën e saj siç përcaktohet në këtë rregullore.”*, zëvendësohet me togfjalëshin *“sipas përcaktimeve të nenit 14 të kësaj rregulloreje.”*;

b) Në nenin 6, pika 2, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në shkronjën “g”, fjala *“këstit”*, zëvendësohet me fjalën *“kësteve”*;

ii. në shkronjën “o”, togfjalëshi *“(kësteve/principalit/interesit)”*, zëvendësohet me togfjalëshin *“(këstit/ kësteve të kredisë, që në çdo rast përfshijnë vetëm kryegjënë dhe interesin)”*;

c) Në nenin 7, pika 2, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në shkronjën “j”, togfjalëshi *“shumën e këstit”*, zëvendësohet me togfjalëshin *“vlerën e kësteve”*;

ii. në shkronjën “p”, togfjalëshi *“(kësteve/principalit/interesit)”*, zëvendësohet me togfjalëshin *“(këstit/ kësteve të kredisë, që në çdo rast përfshijnë vetëm kryegjënë dhe interesin)”*, si dhe pas togfjalëshit *“(këstit/ kësteve të papaguara të kredisë”*, shtohet togfjalëshi *“, që në çdo rast përfshijnë vetëm kryegjënë dhe interesin”*;

d) Në nenin 14, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“1/1. Përjashtim nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni bën kategoria e kredisë konsumatore me këste, në intervalin e shumave të disbursuara 0-200.000 lekë (ose ekuivalenti në monedhat e huaja), për të cilën Banka e Shqipërisë përcakton normën efektive maksimale të interesit sa mesatarja e thjeshtë e normës efektive të interesit për kredinë konsumatore me këste në intervalin e lartpërmendur.”;

e) Pas nenit 15, shtohet neni 15/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Neni 15/1

Kërkesa për komisionet në kontratat e kredisë konsumatore

Për kontratat e kredisë konsumatore, komisionet që lidhen me aplikimin për kredi, procesimin, administrimin, miratimin dhe disbursimin e kredisë, paguhen nga konsumatori në momentin e disbursimit të kredisë dhe nuk shpërndahen gjatë jetëgjatësisë së kredisë.”

2. Ngarkohen subjektet e kësaj rregulloreje me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të pikës 1, shkronja “e” e këtij vendimi, e cila hyn në fuqi më 1 maj 2025.

KRYETAR
Gent Sejko